

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN GOSTRIMË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në komunën Gostrimë, aktualisht njësia Administrative Bashkisë Cërrik, me objekt: “Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri më 31.07.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 161, datë 17.12.2015.

Bazuar në nenet 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 871/12, datë 17.12.2015, i ka rekomanduar z. Altin Toska, Kryetar i Bashkisë Cërrik, në të cilën përfshihet njësia Administrative Gostrimë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna nga Drejtoria e Auditimit pranë Prefektit të Qarkut Elbasan, për diferencën 4,778,655 lekë taksa vendore, të pa arkëtuara, sipas shkresës nr. 17/2, datë 3.3.2014 si dhe detyrimet e prapambetura të vitit 2011 në shumën 1,640,900 lekë .

Rekomandimi: Bashkia Cërrik në të cilën përfshihet njësia administrative Gostrimë të marrë masa, për zbatimin rekomandimeve të lëna nga Drejtoria e Auditimit pranë Prefektit të Qarkut Elbasan, duke zbatuar të gjitha procedurat administrative dhe ligjore, si dhe të kryhen të gjithë hapat në shkallët gjyqësore, për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit në vlerën **4,778,655 lekë** taksa vendore të pa arkëtuara dhe detyrime të prapambetura të vitit 2011 në shumën **1,640,900 lekë**.

2. Gjetje nga auditimi: U konstatua se komuna Gostimë në faturat e pa likuiduara për investime dhe shpenzime operative deri më datë 07.07.2015, ka paraqitur vlerën 15 milion lekë, e cila do të rëndojë buxhetin e Bashkisë Cërrik në vazhdim ..

Rekomandimi: Bashkia Cërrik në të cilën përfshihet njësia administrative Gostrimë të marrë masa, për shlyerjen e borxhit ndaj të tretëve në vitin 2016, subjekteve juridike e fizike për vlerën 15 milion lekë, për të respektuar kushtet e kontratave dhe për të evituar kamat vonesat, sipas listës analitike të pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

3. Gjetje nga auditimi: Në auditimi i bilancit kontabël u konstatua se:

- Nuk janë azhurnuar ditarët e kontabilitetit në partitarët analitik për çdo llogari, pra llogaritë sintetike nuk janë azhurnuar e inventarizuar me llogaritë analitike. Nuk është mbajtur ditari i veprimeve të ndryshme për sistemimin e disa llogarive për efekt të mbylljes bilancit.

- Nuk është mbajtur centralizatori, për rrjedhojë veprimet janë hedhur ekstrakontabël në bilanc.

Rekomandimi: Bashkia Cërrik në të cilën përfshihet njësia administrative Gostrimë, Sektori i financës të marrë masa, për mbajtjen e plotësimin e ditarit të veprimeve të ndryshme, për mbajtjen e centralizatorit, për azhurnimin e llogarive sintetike të bilancit në llogaritë analitike të inventarizuara, si dhe të kuadrojë kalimet e veprimeve nga ditarët në centralizator dhe bilanc, për efekt të saktësisë të bashkimit llogarive vjetore të njësisë me Bashkinë Cërrik në kuadër të riorganizimit dhe reformës të pushtetit vendor.

4. Gjetje nga auditimi: Komuna Gostimë, Elbasan në miratimet e strukturave organike të administratës për vitet 2013, 2014 dhe 2015, nuk ka parashikuar strukturë të veçantë për administrimin, inventarizimin, gjendjes faktike dhe mbledhjen e të ardhurave nga kontratat e qirave të aseteve në administrim të Komunës, e cila është në kundërshtim me VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”, pika 9.

Rekomandim: Bashkia Cërrik në të cilën përfshihet njësi administrative Gostrimë të marrë masa, për ngritjen e strukturës për administrimin dhe inventarizimin e aseteve të Njësisë Administrative Gostimë.

5. Gjetje nga auditimi: Komuna Gostimë nuk ka përfunduar vlerësimin faktik të pronave të listuara me VKM nr.129, datë 20.2.2013 “*Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore (866 fletë dhe numër rendor 968)* të cilat janë transferuar në pronësi të saj. Nuk ka zgjidhur problemet me njësitë vendore kufitare për pronat për të vijuar me fazën tjetër atë të përpilimit të listave përfundimtare bazuar në VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “*Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore*”.

Rekomandim: Bashkia Cërrik në të cilën përfshihet njësi administrative Gostrimë, të hartojë një program të miratuar nga Titullari, për ngritjen e grupeve të punës, për të bërë verifikimin në terren të përcaktimeve të bëra në lista përkatëse dhe azhurnim të listave përfundimtare të cilat do të miratohen me VKM. Njëkohësisht Bashkia Cërrik të filloj me inventarizimin fizik të pronave mbështetur në Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” neni 11/4 dhe nenin 12/f dhe me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011” *Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*”kap.IV “*Sistemi periodik i aktiveve*”.

6. Gjetje nga auditimi: Komuna Gostimë për sipërfaqen pyjore 1004.91 ha, sipërfaqen kullimore, livadhet 74.16 ha, sipërfaqen ujore 34.4 ha, 16 liqene ose gjole, nuk ka realizuar marrjen në dorëzim të shoqëruar me inventarizimin fizik të gjëndjes pyjore në terren, për verifikimin e përcaktimeve të pasqyrës së bashkëlidhur VKM nr.681 datë 21.5.2008 “*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Gostimë, të Qarkut Elbasan*”. Komuna nuk ka bashkëpunuar me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor dhe njësitë vendore kufitare për territorin e shtrirjes të këtij fondi dhe saktësimin në hartat shoqëruese të kufijve nën administrimin e Komunës Gostimë. Si rezultat i kësaj nuk janë bërë akoma azhurnimet përfundimtare në hartë për përcaktimin e kufijve administrativ ndërmjet Komunave. Komuna nuk ka kryer procedurat teknike dhe ligjore për regjistrimin e këtyre pronave në ZVRPP Elbasan, në kundërshtim me kërkesat e nenit 8 të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “*Për fondin kullor*”, i ndryshuar.

Rekomandim: Bashkia Cërrik në të cilën përfshihet njësi administrative Gostrimë të marrë masa, për ngritjen e grupeve të punës për inventarizimin e pasurive të llojit pyll dhe kullotë, si dhe regjistrimin e tyre pranë ZVRPP Elbasan.

7. Gjetje nga auditimi: Komuna Gostimë nuk ka zbatuar kërkesat e VKM nr.121 datë 17.2.2011 ” *Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe/ose bashki*”, kreu IV ”Detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e funksionimit të zyrave të menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në Komuna”, pika”1”, në fakt ka vetëm një agronom të emëruar pranë zyrës së shërbimeve .

Rekomandim: Bashkia Cërrik në të cilën përfshihet njësi administrative Gostrimë, të marrë masa për ngritjen e ZMMT dhe plotësimin e saj me personel sipas kërkesave të VKM nr.121 datë 17.2.2011.

8. Gjetje nga auditimi: Komuna Gostimë nuk ka zbatuar procedurat për ndarjen e tokave të lira ose dhënien me qira, pronë e komunës me sipërfaqe **403 ha**, në zbatim të VKM nr .531, datë 21.8.1998 ”*Për tokat bujqësore të pandara*” pika 3, dhe VKM nr.121 datë 17.2.2011, kreu IV, pika “e”, për të cilat mungon programi i punës nga komuna për trajtimin e kësaj prone.

Rekomandimi: Bashkia Cërrik në të cilën përfshihet njësi administrative Gostrimë të marrë masa, për trajtimin e tokës arë, të lirë, në sipërfaqen **403 ha**, të bazuar në një program pune me ekspertë të fushës, për ngritjen e komisionit, për ndarjen ose dhënien me qira, të shoqëruar këto me hartat përkatëse sipas akteve nën ligjore.

9. Gjetje nga auditimi: Komuna Gostimë nuk ka mbajtur procesverbale për transferimin e zërave kadastralë tokë bujqësore në troje, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 8752, datë

26.3.2001 “Për krijimin edhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës” i ndryshuar si dhe VKM nr.121, datë 17.2.2011, kreu IV ”Detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e funksionimit të zyrave të menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës (ZMMT) në komuna dhe/ose bashki”, kreu IV, pika 2, gërma”f” .

Rekomandimi: Bashkia Cërrik në të cilën përfshihet njësi administrative Gostrimë në bashkëpunim me Zyrën e AMT në Këshillin e Qarkut Elbasan, të marrë masat për evidentimin e ndryshimeve të zërave kadastralë me një regjistër të posaçëm, të shoqëruar me hartat përkatëse dhe të mbajë një kopje të dokumentave në Arkiv.

10. Gjetje nga auditimi: Komuna Gostimë nuk ka mbajtur proces verbale për dëmtimin e tokës bujqësore dhe zërave të tjerë kadastralë të shkaktuar nga faktorë natyrorë për vitet 2013, 2014, 2015, në zbatim të nenit 21 ”Procedura e kontrollit të dëmtimit të tokës bujqësore”, të Ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 ”Për Mbrojtjen e tokës bujqësore”, VKM nr. 121, datë 17.2.2011, kreu IV.

Rekomandimi: Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokave pranë Bashkia Cërrik në të cilën përfshihet njësi administrative Gostrimë,, në bashkëpunim me Zyrën e AMT në Këshillin e Qarkut të Elbasanit, të evidentojë sipërfaqet e tokës bujqësore dhe zërave të tjerë kadastralë të cilat janë dëmtuar nga faktorët natyrorë dhe të kryej ndryshimet në Rregjistrat themeltarë.

11. Gjetje nga auditimi: Komuna Gostimë ka plotësuar pjesërisht Regjistrin themeltar të Tokës, vetëm për fshatrat Shtërmën, Shushicë dhe Çartalloz, në kundërshtim me urdhrin e përbashkët, nr.107, datë 27.3.2009 të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Ministrit të Brendshëm , VKM nr. 121 datë 17.2.2011 ” Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe/ose bashki “ dhe të Ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 ”Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar.

Rekomandim: Bashkia Cërrik në të cilën përfshihet njësi administrative Gostrimë të marrë masa, për plotësimin e Regjistrin themeltar të tokës për të gjithë fshatrat nën juridiksionin e shtrirjes së territorit të ish-komunës, në koordinim me Zyrën e AMT në Këshillin e Qarkut Elbasan.

12. Gjetje nga auditimi: Komuna Gostimë nuk ka mbajtur evidenca të plota, të rakorduara me proces verbale dhe akt-verifikime vjetore mbi gjëndjen faktike, sipas fshatrave, për zërat kadastralë, tokë arë, pemishte, vreshta, ullishte, për sipërfaqet e pyjeve, kullotave, për trojet, për hapësirat e tjera si lumenj, rezervuarët, përrenjtë, kanalet kullues e vaditës, rrugët e fshatrave, ato nacionale, sipërfaqet si troje të zëna për varreza, sipërfaqet shkëmbore etj për të krijuar një gjykim të plotë mbi pasuritë e paluajtshme .

Rekomandim: Bashkia Cërrik në të cilën përfshihet njësi administrative Gostrimë nëpërmjet Zyrës së Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokave (ZMMT), të marrë masa që në bashkëpunim me AKKP, Zyrën e AMT në Këshillin e Qarkut dhe ZVRPP Elbasan, të saktësohen me evidenca pronat shtet dhe ato private, të shoqëruar këto me hartat përkatëse dhe të mbajë një kopje të dokumentave në Arkiv.

13. Gjetje nga auditimi: Komuna Gostimë, për vitet 2012-2015 ka mangësi në inventarizimin e dosjeve të tenderave dhe arkivimin e tyre, në kundërshtim me udhëzimet e APP-së, me nenin 30 të Modelit nr. 8 “Norma Teknike Profesionale dhe Metodologjike Shërbimit Arkivor RSH”, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” .

Rekomandim: Bashkia Cërrik në të cilën përfshihet njësi administrative Gostrimë të marrë masa dhe të kryej inventarizimin dhe arkivimin e të gjitha dosjeve të tenderave.

14. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e taksave dhe tarifave vendore në komunën Gostimë, u konstatua se:

a. Debitorët e taksave vendore për 95 subjekte të biznesit vogël e juridike deri më datë 01.7.2015, paraqiten për vlerën 5,7 milion lekë, të cilët nuk janë pasqyruar në bilancin e vitit 2015. Mos arkëtimi i debitorëve, mungesa e masave sekuestruese ndaj tyre, mungesa e

lëshimit të autorizimit të ndërhyrjes me forcë të Policisë komunës për disiplinimin e debitorëve, bie ndesh me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" neni 88 e 93, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", neni 17 "Kundërvajtjet dhe sanksionet", pika 3, me Rregulloren e Brendshme të Komunës të miratuar në KK, me udhëzimin e MF nr. 655/1, datë 06.02.2007 "Për përcaktimin e uniformitetit të Standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore"; neni 17 dhe neni 34, shkronja "a", pika 3.

b.-Subjektet e parregjistruara në komunën Gostimë nuk janë evidentuar dhe ndaj tyre nuk ka sanksione ligjore, në kundërshtim me pikën 1 të ligjit nr. 10415, datë 7.4.2011 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008", administrata tatimore për subjektet e parregjistruara në QKR, nuk ka mbyllur veprimtarinë ekonomiko tregtare dhe nuk ka konfiskuar materialet, sipas neni 121 të këtij ligji. Ushtrimi i aktivitetit pa u regjistruar në zyrën e taksave vendore të Komunës, përbën kundërvajtje administrative. Nga Taksat Vendore nuk është bllokuar veprimtaria apo sekuestrimi i pasurive në vendin e biznesit për të gjithë subjektet pa leje, sanksione këto të përcaktuara me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" neni 41, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", neni 17 "Kundërvajtjet dhe sanksionet", pika 4.

Rekomandimi: Bashkia Cërrik në të cilën përfshihet njësi administrative Gostrimë të marrë masa, të ngrejë grup pune e në bashkëpunim me policinë bashkiake të marrë masat e mëposhtme:

- kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës 5,7 milion lekë, të taksave vendore të papaguara të 95 subjekteve të biznesit vogël e juridike, duke ndjekur të gjitha hapat ligjore deri në sekuestrim pasurie të subjekteve debitorë sipas pasqyrës në projekt raportin e auditimit.
- evidentimin, rregjistrimin dhe vjeljen e detyrimeve të subjekteve të parregjistruara.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bashkia Cërrik në të cilën përfshihet njësi administrative Gostrimë të marrë masa dhe të kryej kontabilizimin e detyrimeve, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërbllimin e vlerës **9,615,916 lekë dëm ekonomik** në mënyrë analitike, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: U konstatua se **17 këshilltar** të Komunës Gostimë kanë përfutur padrejtësisht pagë, për vlerën **1,349,400 lekë dëm ekonomik**, pasi nuk kanë marrë pjesë në disa mbledhje të këshillit për vitin 2013, 2014 dhe 2015, sipas protokollit të mbledhjeve të Këshillit Komunës dhe borderove përkatëse, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", me ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore" kreu VI, neni 29, pika 2 neni nr. 31, pika 2 dhe 8, neni 37 pika 2.

Rekomandimi: Bashkia Cërrik në të cilën përfshihet njësi administrative Gostrimë të marrë masa, të kryej arkëtimin e vlerës **1,349,400 lekë**, për pagesat e përfutuara padrejtësisht gjatë përiudhës 2013, 2014 dhe 2015, nga 17 këshilltarë të komunës Gostimë, pasi nuk kanë marrë pjesë në disa mbledhje të këshillit.

2. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2014, makina tip Benz e administratës komunës Gostimë, në përdorimin e saj nuk justifikohet **1000 litra** karburant të harxhuara me vlerë **187,900 lekë dëm ekonomik** (1,000x187,9), pasi fletudhëtimet janë të parregullta dhe nuk përputhen kilometrat e përshkruara me tabelën e miratuar nga Këshilli i Qarkut Elbasan dhe DSHTRR, madje për distanca të njëjta pasqyrohen km të ndryshme, konkretisht: rrugë të brendshme brenda komunës pasqyrohen deri 130 km nga 30 km normalja ditore, etj. Veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e

sektorit publik” dhe me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”

Rekomandimi: Bashkia Cërrik në të cilën përfshihet njësia administrative Gostrimë të marrë masa dhe të kërkojë arkëtimin e vlerës **187,900 lekë për 1000 litra karburant** të pajustificuara, përkatësisht nga shoferët *N.M.vlerë 46,975 lekë* dhe *B.Xh vlera 46,975 lekë*, llogaritaria e magazinës *M.M vlerë 46,975 lekë* dhe magazinieria *H.B vlerë 46,975 lekë*.

3. Gjetje nga auditimi: Zyra e taksave vendore për vitin 2013, 2014 dhe 2015 nuk ka kryer ndalesat nëpërmjet borderove, për detyrimet e taksave vendore për administratën, shërbimet, këshilltarët dhe kryepleqtë e komunës Gostimë për **38 persona** me vlerën **522,325 lekë të ardhura të munguara** (sipas pasqyrës analitike në raportin e auditimit), në kundërshtim me nenet 30, 33, 34 dhe 46, të ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Rekomandimi: Bashkia Cërrik në të cilën përfshihet njësia administrative Gostrimë, të arkëtojë vlerën **522,325 lekë**, si taksa vendore të pa arkëtuara në vitin 2013, 2014 dhe 2015 për administratën, shërbimet, këshilltarët dhe kryepleqtë e komunës Gostimë.

4. Gjetje nga auditimi: Është konstatuar dëm ekonomik në vlerën **758,448 lekë**, në tenderin “Ndërtim e Sistemit tregu te lirë Gostimë per vitin 2013”, pasi nga njësia e prokurimit dhe projektuesi është rritur artificialisht fondi limit, sepse sipërfaqja e tregut në preventiv nuk përputhet me sipërfaqen e miratuar në projektzbatimin dhe planimetrinë e miratuar për diferencën 2,290 m2 (13,270- 15,560).

Rekomandimi: Bashkia Cërrik në të cilën përfshihet njësia administrative Gostrimë, të kryej arkëtimin e vlerës **758,448 lekë**, përkatësisht: nga znj. E.Z vlerë 189,612 lekë, L.L vlerë 189,612 lekë, L.K vlerë 189,612 lekë anëtarë të njësisë së prokurimit dhe R.T projektues vlerën 189,612 lekë, pasi nuk kanë llogaritur saktë fondin limit, duke e rritur atë, sepse sipërfaqja e tregut në preventiv (situacion) nuk përputhet me sipërfaqen e miratuar në projektzbatimin dhe planimetrinë e miratuar për diferencën 2,290 m2 (15,560-13,270).

5. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksion i Ujesjellesit ne Lagjen e Kashareve dhe ne fshatin Cartallos ,Depo e Klorinimit fshati Malasej si dhe ndertimi i cesmes publike ne fshatin Shushicë ,Komuna Gostimë”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **524,447 lekë dëm ekonomik** nga “Blerimi” sh.p.k, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

Rekomandimi: Të kërkohej arkëtimi i dëmit nga subjekti “**Blerimi**” sh.p.k, për vlerën **524,447 lekë**, për punime të pakryera në objektin “Rikonstruksion i Ujesjellesit ne Lagjen e Kashareve dhe ne fshatin Cartallos ,Depo e Klorinimit fshati Malasej si dhe ndertimi i cesmes publike ne fshatin Shushice, Komuna Gostimë”, sipas kontratës për punë publike me nr. 29, datë 15.08.2013.

6. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksion i Shkolles së Mesme të Përgjithshme Gostimë për vitin 2013”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **046,040 lekë dëm ekonomik**, për punime të pakryera, nga “E...” sh.p.k, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

Rekomandimi: Të kërkohej arkëtimi i dëmit nga subjekti “E...” sh.p.k, për vlerën **046,040 lekë** për punime të pakryera, në objektin “Rikonstruksion i Shkolles se Mesme te Pergjithshme Gostime”, sipas kontratës datë 14.10.2013.

7. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Ndërtim –Sistemit tregu te lirë Gostimë për vitin 2013”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **883,285 lekë dëm ekonomik**, për

punime të pakryera, nga “V... H...” sh.p.k, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar .

Rekomandimi: Të kërkohet arkëtimi i dëmit nga subjekti “Vëllezërit Hysa” sh.p.k, për vlerën **883,285 lekë lekë**, për punime të pakryera, në objektin “Ndërtim –Sistemit tregu të lirë Gostimë për vitin 2013”, sipas kontratës datë datë 14.10.2013.

8. Gjetje nga auditimi: Njësia e prokurimit ka ndërtuar kriterin e veçantë për mjetet në dispozicion, për të kufizuar të operatorët tjerë dhe për të favorizuar operatorin fitues. Kështu u konstatua vlera **4,628,795 lekë dëm ekonomik** (16,634,800-12,006,005), në tenderin me objekt:”Rikonstruksion i Ujsjellësit të fshatit Malasej, Komuna Gostimë në vitin 2012”, si diferencë midis firmës fituese dhe asaj me vlerë më të ulët, pasi padrejtësisht është shpallur fitues operatori ekonomik “B...”shpk me vlerë 16,634,800 lekë lekë, në vend të operatorit ekonomik “E...”shpk me vlerë 12,006,005 lekë, e cila paraqet ofertë të leverdishme ekonomike, dokumentacion të rregullt sipas kërkesave të përcaktuara në DST. KVO ka skualifikuar padrejtësisht Firmën E... shpk për kriterin e veçantë atë të mjeteve të disponueshme, pasi disponon 4 mjetet e kërkuara nga këto 2 janë 18 tonshe dhe 2 janë 10 tonshe, nga 4 mjete që kërkoheshin në DST me kapacitet 10-tonshe, çka nuk përbën problem thelbësor në kualifikimin e subjektit në fjalë. KVO gjatë vlerësimit të ofertës së Elira sh.p.k, nuk i është përmbajtur pikës 5 “Vlerësimi i Ofertave” nën-pika 5.5 të DST, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar “Për prokurimin publik”, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2 .

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **4,628,795 lekë**, përkatësisht nga M.L, F.K, I.H, ish anëtarë të KVO, dhe znj.E.Z, L.L dhe L.K anëtarë të Njesisë e Prokurimit nga **771,466 lekë/secili**, për diferencë midis firmës fituese dhe asaj me vlerë më të ulët, pasi padrejtësisht fitues është shpallur “B..sh.p.k” me vlerën 16,634,800 lekë lekë, në vend të operatorit ekonomik “E... sh.p.k” me vlerë 12,006,005 lekë me ofertë të leverdishme ekonomike dhe me dokumentacion të rregullt, në tenderin me objekt:”Rikonstruksion i Ujsjellësit të fshatit Malasej, Komuna Gostimë” në vitin 2012.

9. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksion i KUZ, HC Banjë, në fshatin Shtëpanjë,viti 2014, Komunës Gostimë” rezultoi se vlera **803,176 lekë dëm ekonomik**, për përdorimin e paargumentuar të procedurës “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit”. Kjo procedurë është realizuar me arsyen e çarjes së tubacionit dhe bllokimit dhe amortizimit të ujrave të zeza të HC Banjë në fshatin Shtëpanjë pa pasur shkaqe ekstreme për përdorim të saj dhe pa miratim në Këshillin e Komunës.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **803,176 lekë**, përkatësisht nga E.Z, L.L, M.M, anëtarë të njesisë së prokurimit dhe z. Q.B, ish-titullar i autoritetit kontraktor me nga **200,794 lekë secili** për përdorimin e pa argumentuar te procedurës “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit” dhe pa miratim të Këshillit Komunës, për objektin “Rikonstruksion i KUZ, HC Banjë, në fshatin Shtëpanjë”

C. MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në nenin 58 germa ç, c, b, a “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe nenit ..të kontratave individuale të punës, në nenin 44, të ligjit nr. 8652, datë 31/7/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, **kërkojmë kryetarit të Bashkisë Cërrik, në të cilën përfshihet njësia administrative Gostimë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe **marrjen e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”** dhe për ata me kontratë, nga masa “Vërejtje” deri në “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, për këta punonjës:

1. znj.E.Z, juriste dhe në cilësinë e p/njesisë prokurimit, për shkeljet e mëposhtme:

-për 3 raste shkelje ligjore në procedurat e prokurimeve publike me efekte financiare për vlerën 6,190,419 lekë dëm ekonomik dhe mos efektivitet të fondeve publike, për vitin 2012, 2013, 2014, konkretisht:

a. Në procedurën e prokurimit publik në objektin: *Rikonstruksion i KUZ, HC Banjë, në fshatin Shtëpanjë, viti 2014, Komunës Gostimë*, është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 803,176 lekë, nga përdorimi i paargumentuar i “*Procedurës me negociim, pa botim paraprak të njoftimit të kontratës*”, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, neni 33, pika 1, dhe pa miratim të Këshillit Komunës.

b. Në procedurën e prokurimit publik në objektin: “*Rikonstruksion i Ujsjellësit të fshatit Malasej, Komuna Gostimë në vitin 2012*” është shkaktuar mos efektivitet i fondeve publike në vlerën 4,628,795 lekë si diferencë midis ofertës së operatorit të shpallur fitues Blerimi sh.p.k me vlerë 16,634,800 lekë dhe ofertës së skualifikuar E... sh.p.k me vlerë 12,006,005 lekë, pasi njësia e prokurimit gjatë vendosjes së kushteve të kualifikimit në DST ka aplikuar kushte të veçanta të cilat kufizojnë pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve ekonomik, në kundërshtim me pikën 5 “*Vlerësimi i Ofertave*” nën pika 5.5 të DST dhe me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, neni 2 “*Parimet e përzgjedhjes*” pika “c”.

c. Në procedurën e prokurimit publik në objektin: “*Ndërtim e Sistemim tregu te lirë Gostimë, per vitin 2013*” është rritur artificialisht fondi limit duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 758,448 lekë, pasi ka mospërputhje në dokumentet standarde tenderit, konkretisht: në preventiv pasqyrohet tepër sipërfaqja (*situacioni 2,290 m2*), ndryshe nga projektzbatimi dhe planimetria e miratuar ku hapësira funksionale e tregut është 10,231 m2 (*situacioni 13,270 m2*) dhe jo 15,560 m2, në kundërshtim me nenin 5, Kreu III të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar, me Kreun V pika 1, 2 të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*” dhe me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin Publik*” i ndryshuar.

- Pë mangësi në inventarizimin e dosjeve të tenderëve dhe arkivimin e tyre, për vitet 2012-2015, në kundërshtim me udhëzimet e APP-së, me nenin 30 të Modelit nr. 8 “*Norma Teknike Profesionale dhe Metodologjike Shërbimit Arkivor RSH*” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “*Për Arkivat*”.

2. znj. L.L, p/urbanistikës dhe në cilësinë e anëtares njësisë prokurimit, për shkeljet e mëposhtme:

-për 3 raste shkelje ligjore në procedurat e prokurimeve publike me efekte financiare për vlerën 6,190,419 lekë dëm ekonomik dhe mos efektivitet të fondeve publike, për vitin 2012, 2013, 2014, konkretisht:

a. Në procedurën e prokurimit publik në objektin: *Rikonstruksion i KUZ, HC Banjë, në fshatin Shtëpanjë, viti 2014, Komunës Gostimë*, është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 803,176 lekë, nga përdorimi i paargumentuar i “*Procedurës me negociim, pa botim paraprak të njoftimit të kontratës*”, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, neni 33, pika 1, dhe pa miratim të Këshillit Komunës.

b. Në procedurën e prokurimit publik në objektin: “*Rikonstruksion i Ujsjellësit të fshatit Malasej, Komuna Gostimë në vitin 2012*” është shkaktuar mos efektivitet i fondeve publike në vlerën 4,628,795 lekë si diferencë midis ofertës së operatorit të shpallur fitues Blerimi sh.p.k me vlerë 16,634,800 lekë dhe ofertës së skualifikuar E.. sh.p.k me vlerë 12,006,005 lekë, pasi njësia e prokurimit gjatë vendosjes së kushteve të kualifikimit në DST ka aplikuar kushte të veçanta të cilat kufizojnë pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve ekonomik, në kundërshtim me pikën 5 “*Vlerësimi i Ofertave*” nën pika 5.5 të DST dhe me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, neni 2 “*Parimet e përzgjedhjes*” pika “c”.

c. Në procedurën e prokurimit publik në objektin: “*Ndërtim e Sistemim tregu te lirë Gostimë, per vitin 2013*” është rritur artificialisht fondi limit duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 758,448 lekë, pasi ka mospërputhje në dokumentet standarde tenderit, konkretisht: në preventiv pasqyrohet tepër sipërfaqja (*situacioni 2,290 m2*), ndryshe nga projektzbatimi dhe planimetria e miratuar ku hapësira funksionale e tregut është 10,231 m2 (*situacioni 13,270*

m2) dhe jo 15,560 m2, në kundërshtim me nenin 5, Kreu III të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, me Kreun V pika 1, 2 të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” dhe me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar.

3. znj. L.K, financiere dhe në cilësinë e anëtares njësisë prokurimit, për shkeljet e mëposhtme:

-për 2 raste shkelje ligjore në procedurat e prokurimeve publike me efekte financiare për vlerën 5,387,743 lekë, konkretisht:

